




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT



AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE TIRANË

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE INDUSTRIALE "PAVARËSIA" VLORE

Nr. 792 Prot

Vlorë , më 04.08.2026

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele .

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore ,

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun".

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr 759 datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve , ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit "(të ndryshuar),

Ofruesi publik i AFP-së SHKOLLA INDUSTRIALE "PAVARESIA "VLORE , ju njofton krijimin e vendit të lirë për 1 pozicione pune :

- Pozicioni 1 .

Dega-Mekanike profili makina metal -punuese tornitor frezator për instruktor të praktikës profesionale (me kohë të plotë)

1. Kriteret të përgjithshme dhe kriteret e posaçme.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës ,sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për instruktor të praktikës profesionale (me kohë të plotë) në ofruesit e AFP-së për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare, në të njëjtën fushë me kualifikimin / kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon.
- b) të ketë të paktën 3(tre) vjet përvojë pune në fushën, më të cilat ka kryer studimet
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

d) aftësi të tjera nëse kërkohen

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit për lëvizje paralele, duhet të përfshijë: -

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën + listen e notave
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi, të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;
- Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit public të AFP-së, brenda datës,

13/08/2026

3. Vlerësimi I kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr 759 datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësive të zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit" (të ndryshuar),

DREJTOR

ING. GENTIAN BOCI

Bulevardi kryesor, "Ismail Qemali" Vlorë, Lagja "Pavarësia", E-mail: industriale11@yahoo.com